

L I G J
Nr.9472, datë 9.2.2006

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË AMENDAMENTIN E KONVENTËS
“PËR NDALIMIN OSE KUFIZIMIN E PËRDORIMIT TË ARMËVE TË QUAJTURA
KONVENCIONALE, TË CILAT MUND TË KONSIDEROHEN SE SHKAKTOJNË
DËMTIME TË MËDHA OSE PASOJA PA DALLIM”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në amendamentin e Konventës “Për ndalimin ose kufizimin e përdorimit të armëve të quajtura konvencionale, të cilat mund të konsiderohen se shkaktojnë dëmtime të mëdha ose pasoja pa dallim”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4794, datë 3.3.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

KONVENTA

**MBI NDALIMIN OSE KUFIZIMIN E PËRDORIMIT TË DISA ARMËVE TË CAKTUARA
KONVENCIONALE, TË CILAT MUND TË KONSIDEROHEN SE SHKAKTOJNË DËMTIME TË
RËNDA OSE SJELLIN PASOJA PA DALLIM**

Gjenevë, 10 tetor 1980
Amendament i nenit 1-21.12.2001

Neni 1

Qëllimi kryesor i zbatimit

Kjo Konventë dhe protokollet e aneksuara do të zbatohen në situata të cilat përmenden në nenin 2 të konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949 për mbrojtjen e viktimave të luftës, përfshirë çdo situatë të përshkruar në paragrafin 4 të nenit 1 të protokollit të parë shtesë të këtyre konventave.

Kjo Konventë dhe protokollet e aneksuara do të zbatohen gjithashtu, përveç situatave të parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni, edhe në situatat që referohen në nenin 3, e përbashkët të konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949. Kjo Konventë dhe protokollet e aneksuara të saj nuk do të zbatohen për situatat në konfliktet dhe tensionet e brendshme, si për shembull RIOTS, aktet e izoluar dhe sporadike të dhunës, dhe akte të tjera të një natyre të ngjashme, për sa kohë që nuk janë konflikte të armatosura.

Në rastin e konflikteve të armatosura që nuk kanë karakter ndërkombëtar, që ndodhin në territorin e njërit prej Shteteve Palë Kontraktuese, secila palë në konflikt do të detyrohet të zbatojë

ndalimet dhe kufizimet e kësaj Konvente dhe protokollet e aneksuara të saj.

Asgjë në këtë Konventë ose në protokollet e aneksuara të saj nuk do të kuptohet si justifikim për qëllimin e prekjes së sovranitetit të një shteti ose përgjegjësisë së qeverisë, përmes gjithë mjeteve të ligjshme, të mirëmbajnë ose të rivendosin rregullin dhe ligjin në shtetin e tyre ose atë mbrojnë unitetin kombëtar dhe integritetin territorial të shtetit.

Asgjë në këtë Konventë ose në protokollet e aneksuara të saj nuk do të kuptohet si justifikim për qëllim të ndërhyrjes direkte ose jo, për çfarëdo arsye, në një konflikt të armatosur ose në punët e brendshme ose të jashtme të Shteteve Palë Kontraktuese në territorin e së cilës ndodh konflikti.

Zbatimi i dispozitave të kësaj Konvente dhe protokolleve të aneksuara të saj për palët në një konflikt, të cilat nuk janë Shtete Palë Kontraktuese që kanë pranuar këtë Konventë ose protokollet e aneksuara të saj, nuk do të ndryshojnë statusin e tyre ligjor ose statusin ligjor të vendeve në konflikt në mënyrë të hapur ose jo.

Dispozitat e paragrafëve 2 deri 6 të këtij neni nuk do të cenojnë protokollet shtesë të adoptuara pas 1 janarit 2002, të cilat mund të zbatohen, të përjashtojë ose modifikojë qëllimin e zbatimit të tyre për sa i përket këtij neni.